



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 18 të Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal Nr.04/L-010, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.7 e datës 10 gusht 2011, nenit 6 par. 3 të Rregullores për procedurën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar Nr.0203 - 1334 e datës 18.12.2012, si dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës 29.03.2018 të miratojë këtë

V E N D I M

PËR AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË KOMUNËS PËR PËRFAQËSIMIN E KOMUNËS SË LIPJANIT MBI VENDOSJEN E BASHKËPUNIMIT KOMUNAL NDËRKOMBËTAR

Neni 1

AUTORIZOHET, Kryetari i Komunës për përfaqësimin e Komunës së Lipjanit, gjatë bisedimeve për bashkëpunim komunal ndërkombëtar ndërmjet komunave të Italisë Civita dhe Frascineto me komunat e Republikës së Kosovës Lipjan dhe Fushë Kosovë dhe në bazë të këtyre konsultimeve të përgatitet Marrëveshja e cila do ti dërgohet Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal për të vlerësuar ligjshmërinë sipas procedurës së paraparë me nenin 6 par. 6 të Rregullores për procedurën e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar

Neni 2

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 016-20227
Lipjan, më 30.03. 2018

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

KRYESUESI I KUVENDIT
Dauf Azemi

